Forma e ruajtjes së dokumentave/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)

Dokumentet që krijohen, hyjnë në apo dalin nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ruhen, përpunohen dhe administrohen në arkivën e institucionit. Funksionimi i sistemit të ruajtjes së dokumenteve mbështetet në aktet ligjore dhe nënligjore të tilla si Ligji Nr. 9154 datë 6.11.2003 “Për arkivat", VKM Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullorja e Brendshme “Për Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” e miratuar me Urdhër Nr. 297, datë 23.6.2022 të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Bazuar në këto akte ligjore, zyra e Sekretari/Protokollit harton pasqyrat emërtuese të çeljes së dosjeve në bazë të kritereve arkivorë, si: të objektit, të autorit, të korrespondentit, të ndarjes sipas drejtorive, të llojit të dokumentit, të kohës dhe afatit të ruajtjes me RHK dhe të përkohshme.

Dokumentacioni në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit ruhet në format “kopje fizike”. Kohëzgjatja dhe formati i ruajtjes ndryshojnë në varësi të llojit të dokumenteve, si dhe kushtëzohen nga aktet rregullative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe aktet e brendshme të institucionit.